



Project funded by the
European Union



UDHËZUES PËR APLIKANTËT – ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË) NË KUADËR TË THIRRJES SË TRETË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME NË PROGRAMIN RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të interesuara në procesin e dorëzimit të projekt -propozimeve në kuadër të Thirrjes së Tretë Publike për OSHC-të në bashkinë Lezhë

ReLOaD dhe partneriteti me Bashkinë Lezhë

Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur shoqërinë civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke stimuluar dhe krijuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për të. Disa nga rezultatet që projekti **ReLOaD** do të arrijë janë:

- Bashkitë do të përdorin modele transparente dhe të bazuara në projekte konkrete për financimin e OSHC-ve;
- OSHC-të do të ofrojnë shërbime të cilat adresojnë nevojat e qytetarëve në bashkitë partnere dhe janë në zbatim të planeve dhe strategjive lokale për zhvillim;
- Kapacitete të fuqizuara të OSHC-ve dhe njësisve të pushtetit vendor për të zbatuar skemat e grantit dhe ofruar projekte cilësore;
- Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal, dialogut, ndarjes së praktikave ndërmjet njësisve të pushtetit vendor dhe OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor.

Bashkia e Lezhës është partnere e programit ReLOaD dhe në këtë kuadër në bashkinë Lezhë janë hapur dy thirrje publike për OSHC-të në 2018 dhe 2019 me një buxhet total prej 13,730,376 ALL, 25% të së cilit janë kontribut financiar i bashkisë.

2. SYNIMI I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DHE PRIORITETET VENDORE

Nëpërmjet kësaj Thirrjeje publike synohet forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njësisve të pushtetit vendor. Në këtë kuadër, ftohen të gjitha OSHC-të e interesuara të dorëzojnë projekt-propozime, të cilat duhet të adresojnë prioritetet strategjike të Bashkisë Lezhë, si më poshtë:

1. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Lezhës

- Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në mbështetje të rritjes së cilësisë së ofertës turistike për vizitorët në Bashkinë Lezhë.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit duke nxitur një bashkëpunim të aktorëve të turizmit dhe qendrat e zhvillimit profesional.

2. Integrimi social i komunitetit për një jetë të shëndetshme dhe aktive.

- Mundësimi i integritit social të fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave dhe grupeve vunerabel për tu përfshirë në menyrë aktive në jetën kulturore dhe komunitare .
- Fuqizimi i kategorive në nevojë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre në prodhimin dhe promovimin e produkteve tradicionale të zonës së Lezhës (zeje, punime me dorë etj).

3. Mjedisi dhe shërbimet publike

- Mbrojtja e mjedisit, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve në territorin e Bashkisë Lezhë.
- Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave.

Këto prioritete janë vendosur bazuar në konsultimet ndërmjet bashkisë dhe organizatave të shoqërisë civile në bashkinë Lezhë, nga sugjerimet e bëra gjatë Info-Day me datë 25.05.2021 si dhe email-eve të dërguara nga organizata.

3. FONDET (GRANTET) QË JANË NË DISPOZICION PËR PROJEKTE

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrjeje publike duhet të jenë me shumat si më poshtë:

- shuma minimale: 1.000.000 Lek
- shuma maksimale: 1.500.000 Lek

OSHC-të të cilat kanë qenë partnere dhe kanë zbatuar projekte në thirrjen e parë dhe të dytë kanë të drejtë të aplikojnë, por vlera totale e grantit për të gjitha thirrjet (miratuar në thirrjen e parë dhe të dytë dhe aplikuar në thirrjen e tretë) nuk duhet të kalojë 5.000.000 ALL përfituar nga projektet e zbatuara në bashkinë Lezhë.

Grantet e alokuara në këtë thirrje publike mund të mbulojnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e personelit deri në masën 30% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% të fondeve, duhet të parashikohen për aktivitete programore të projektit.

Ndërkohë, 50% e vlerës totale mund të parashikohet për blerje pajisjesh dhe/ose rikonstruksione/infrastrukturë, në rastet kur ato janë të domosdoshme për realizimin e qëllimit të projekt propozimit.

Për secilin projekt, 3-5% e vlerës totale të propozuar duhet të parashikohet për aktivitete që lidhen me dukshmërinë/vizibilitetin.

Totali i grantit në Bashkinë e Lezhës për këtë Thirrje është: **3.500.000 Lekë.**

Bashkia ka të drejtën për të mos ndarë të gjitha fondet në dispozicion nëse projekt-propozimet që dorëzohen nga OSHC nuk i përmbushin kriteret e kërkuara.

1. KUSH MUND TË APLIKOJË

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për OSHC-të (shoqatat ose fondacionet) që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri.

OSHC-të do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- janë degë/zyra të organizatave dhe fondacioneve ndërkombëtare, dhe organizatat të tjera ndërkombëtare jo-fitimprurëse të regjistruara për të punuar në Shqipëri;
- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Më konkretisht, përjashtohen nga vlerësimi ato projekte, në të cilat: *Drejtori ekzekutiv, anëtarët e bordit apo personat e planifikuar për tu përfshirë në projekt janë të punësuar në bashkinë apo institucionet e saj të vartësisë në të cilën aplikohet, në pozicionet: Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak, anëtar i kabinetit të Kryetarit të Bashkisë.*
- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e projekt-propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas pikës 9;
- vlera e buxhetit të propozuar është në përputhje me këkresat e thirrjes;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është më e shkurtër se 6 muaj ose më e gjatë se 12 muaj;
- organizata ka qënë parntere e ReLOaD në thirrjen e parë dhe/ose të dytë dhe ka përfituar një grant në total më shumë se 5.000.000 ALL në bashkinë Lezhës.

5 . KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e projekt – propozimit mund të jetë nga 6 deri në 12 muaj.

6. VENDI I ZBATIMIT

Projektet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Lezhë.

7. LLOJET E PROJEKTEVE

- Projekt-propozimet që do të financohen nga kjo thirrje duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen publike dhe prioritetet e Bashkisë Lezhë.
- Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të komunitetit lokal dhe grupeve të targetuara të identifikuara nga projekti.
- Projektet duhet të jenë paketa veprimtarish të integruara dhe metodologjike, të krijuara për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore.

¹ Neni 31 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e granteve:

- Aktivitetet e rregullta të organizatës aplikuese apo organizatës partnere;
- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme (përveç nëse janë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit);
- Financimi i projekteve që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projektet për përfitime ekskluzive të individëve;
- Projektet që mbështesin partitë politike;
- Ndarjen e granteve për palë të treta;
- Blerja e pajisjeve dhe punët rehabilituese/ndërrhyrjet në infrastrukturë përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brenda limiteve të shprehura në pikën 3 të Udhëzuesit.

Aktivitet e sipërpërmendura **NUK** janë shkak për refuzimin automatik të projekt - propozimit, megjithatë do të ndikojnë negativisht në vlerësimin e projekt propozimit. Gjithashtu, nëse projekt – propozimi aprovet për financim, aktivitete të tilla dhe fondet e parashikuara për to do të eliminohen.

8. PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI

OSHC-të e interesuara mund të aplikojnë në mënyrë individuale ose në partneritet me organizata dhe/ose institucione të tjera.

Organizatata partnere

Partnerë të projektit mund të jenë organizata të tjera të shoqërisë civile. Partnerët e OShC-së kandidat marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e projektit, dhe shpenzimet u nënshtrohen rregullave të njëjta si ato të bëra nga vetë OShC-ja kandidatë. Në këtë mënyrë, organizata partnere duhet të përmbushë kushtet e njëjta të legjitimitetit sikurse edhe organizata aplikuese. Nëse aplikojnë në partneritet, organizata aplikuese do të jetë organizata udhëheqëse, dhe në rast të përzgjedhjes, kjo organizatë do të jetë pala kontraktuese (përfituese) dhe do t'i marrë të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare për zbatimin e projektit. **Deklarata e Partneritetit** (Shtojca A) duhet të plotësohet në mënyrë korrekte dhe duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tjera të aplikimit.

Në rast kur aplikimi është në partneritet ndërmjet disa organizatave, të paktën njëra prej tyre duhet të jetë e regjistruar në bashkinë në të cilën po aplikon.

Bashkëpunëtorët: organizata dhe institucione të tjera

Organizatata dhe/apo institucionet tjera (p.sh. shkollat, kopshtet e fëmijëve, muzetë, etj) mund të përfshihen në projekt. Organizatat e tilla – bashkëpunëtorët kanë rol të rëndësishëm në zbatimin e aktiviteteve, mirëpo nuk mund të marrin grante.

9. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

I. Dokumentet kryesore:

- Projekt propozimi (në formatin Word - Shtojca 7)
- Buxheti (formati Excel - Shtojca 8)
- Matrica e kornizës logjike (formati Word – Shtojca 9)
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (formati Excel – Shtojca 10)

Dokumente shitesë (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka)

- Vendimi i regjistrimit të organizatës në Gjykatë dhe ndryshime të tij nëse ka patur.
- Kopja e statutit të organizatës (për organizatën aplikuese dhe partnerët, nëse ka)
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ dhe financiar (formati Word– Shtojca 11)
- Deklarata për plotësimin e kriterëve (formati Word– Shtojca 12)
- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin 2020 të firmosur nga një kontabilist i miratuar ose financieri zyrtar i OSHC-së sipas kriterëve ligjore në fuqi. Në rastin që organizata është themeluar gjatë këtij viti nuk është e nevojshme të dorëzohen pasqyrat.
- Një raport përshkrues i projekteve dhe aktiviteteve të OSHC për vitin paraardhës, përveç rasteve nëse organizata është themeluar gjatë këtij viti.
- Deklarata e partneritetit në rast se OSHC aplikuese ka partnerë (shtojca A).
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B).

Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt – propozimit, dokumentacioni kryesor dhe ai shitesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje është i detyrueshëm.

10. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Dokumentacioni për thirrjen publike për Bashkinë e Lezhës mund të tërhiqet prej **21/06/2021 (dita e hapjes së Thirrjes Publike)** deri në **21/07/2021 (dita e mbylljes së Thirrjes Publike)** duke e dërguar një kërkesë me emrin e organizatës së interesuar në e-mail adresën: pzhvillimi@lezha.gov.al apo personalisht, në adresën:

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN, KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS,
BASHKIA LEZHË
KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret edhe nga faqja e internetit: www.lezha.gov.al

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në tri (3) kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (në CD apo USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), nga ora 09:00 deri në ora 15:00, në adresën:

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN, KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS,
BASHKIA LEZHË
KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 21/07/2021 në ora 15:00 (4 javë nga data e hapjes së Thirrjes Publike). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar emri i thirrjes publike për projekt-propozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit dhe fjalët: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa tjera nuk do të merren parasysh.

Bashkia do të regjistrojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit).

11. INFORMACION TJETËR

Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, bashkia do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura:

1. Bashkia Lezhë do të organizojë një takim informues/ditë të hapur mbi Thirrjen e tretë publike, ku ftohen të marri pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrjeje. Ky takim ka si qëllim, informimin e OSHC-ve mbi elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të. Për Bashkinë Lezhë takim informues do të organizohet më 30/06/2021.
2. Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail adresës pzhvillimi@lezha.gov.al, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më 14/07/2021, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet mund t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm me email.

12. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE

Vlerësimi

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ndërkohë stafi i ReLOaD/UNDP do të jenë në rolin e vëzhguesit në procesin e vlerësimit.

Shënim: OSHC-ja, përfaqësuesi i së cilës është anëtari i Komisionit të vlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile, nuk ka të drejtë të aplikojë në këtë thirrje as si aplikant kryesor dhe as si partner. Përfaqësuesi i shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit të vlerësimit, do të zgjidhet me një proces të hapur gjatë takimit që do të organizohet për Info Day. Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

(i) Kriteret administrative:

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 10 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 9;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (CD apo USB).
- Konfirmimi se organizata aplikuese, partneri (dhe bashkëpunëtorët, nëse ka ndonjë) dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuar në seksionet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 (të përcaktuara më sipër).

(ii) Kriteret të përmbajtjes/vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuar në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: **Secili nën-seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë.** Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt propozimi i radhitur si i pari është ai i cili ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 100;
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga 1.000.000 – 1.200.000 Lek , do të meren në konsideratë për dhënien e grantit, vetëm nëse vlerësohen me më shumë se 60 pikë;
- Projektet të cilat aplikojnë për një shumë granti nga 1.200.000 – 1.500.000 Lek do të meren në konsideratë për dhënien e grantit vetëm nëse vlerësohen me më shumë se 80 pikë.

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

Shënim për Seksionin 1/Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 10 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. E njëjta vlen si për organizatën aplikuese ashtu edhe për partnerët.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë.

Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Relevanca

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 15 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant me qëllimin e thirrjes publike dhe fushat prioritare, cilësia e projektit, rezultatet e pritshme dhe qëndrueshmëria e projektit janë të konsiderueshme si dhe fondet që kërkohen janë në përputhje me aktivitetet e parashikuara.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 15 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti i ka kapacitetet financiare dhe operative, koncepti i projektit nuk është relevant apo në përputhje me përparësitë e përcaktuara në thirrjen publike/ projekti nuk trajton nevojat e komunitetit.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Pikët maksimale	Pikët mesatare
1. Kapacitetet financiare dhe operative	15	
1.1 A kanë aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektesh? Vlerësim maksimal marin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte në fushën për të cilën aplikojnë.	5	
1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? Vlerësim maksimal marin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 10.000 Euro.	5	
2. Relevanca	25	
2.1. Sa relevant është projekti krahasuar me synimin dhe me një apo më shumë përparësi të përcaktuara në thirrjen publike? Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të jepen vetëm nëse projekti trajton të paktën njërin prej përparësive të bëra publike në thirrjen e shpallur	5	
2.2 A janë palët e interesuara të përcaktuara qartë dhe të përzgjedhura në mënyrë strategjike (bashkëpunëtorët, përfituesit përfundimtarë, grupet e synuara)?	5	
2.3 A janë nevojat e grupit të synuar dhe përfituesve përfundimtarë të përcaktuara qartë dhe a i trajton projekti ato në mënyrë e duhur?	5	
1.4 A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë? Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat sjellin risi në zbatimin e projekteve në bashkinë përkatëse.	5	
1.5 A bën projekti avokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (Promovimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ndërkombëtar, rinia, etj.) Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të marginalizuara	5	
3. Metodologjia	20	
3.1 A përshtaten plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara në mënyrë logjike dhe praktike me qëllimet dhe rezultatet e pritshme?	5	
3.2 Sa konsistente është skema e përgjithshme e projektit? (veçanërisht, a e pasqyron analizën e problemeve të identifikuar, faktorët e mundshëm të jashtëm) Vlerësim maksimal marin aplikimet, në të cilat janë marë në konsideratë faktorët e jashtëm (sipas logframe) dhe janë prezantuar masa për eliminimin e tyre.	5	
3.3 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e projektit? Shënim: nëse nuk ka asnjë partner pikët e përfituara do të jenë 1. Këtu nuk përfshihen bashkëpunëtorët.	5	
3.4 A janë përfshirë në projekt tregues objektivist të matshëm? Vlerësim maksimal marin aplikimet, të cilat në logframe kanë indikatorë të qartë e të matshëm.	5	
4. Qëndrueshmëria	25	
4.1 A do të kenë veprimtaritë e propozuara ndikim konkret tek grupet e synuara? Vlerësim maksimal marin aplikimet të cilat lidhin aktivitetet e propozuara me grupet e synuara.	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit në grupe të tjera të synuara ose në vende të tjera dhe/ose shtrirjen e ndikimit të veprimtarive si dhe shkëmbimin e informacionit për përvojën e fituar gjatë zbatimit të projektit)	5	
4.3 A janë rezultatet e pritshme të veprimtarive të sugjeruara të qëndrueshme nga ana institucionale? (a do të ekzistojnë strukturat që mundësojnë veprimtaritë e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë pronësi lokale mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme? (aty ku është rasti, përmendni ndikimin strukturor të veprimtarive të zbatuara – përmirësime në kuadrin ligjor, metoda, kodin e sjelljes, etj.)	5	
4.5 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike lokale dhe/ose cilësinë e jetës në zonën e synuar?	5	
5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos	15	
5.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme?	5	

Vlerësim maksimal marim aplikimet të cilat kanë respektuar ndarjen e % së aktiviteteve sipas udhëzuesit.		
5.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti	5	
- a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për pajisjet teknike)		
- a përmbushet parimi që kostoja administrative dhe e personelit nuk mund të jetë mbi 20 për qind e buxhetit total?		
- a është buxheti me ndjeshmëri gjinore?		
- a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimet e punës, aty ku është e nevojshme?		
Pikët totale maksimale	100	

Njoftimi rreth vendimit

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve u njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 30 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në faqen e internetit të Bashkisë Lezhë (www.lezha.gov.al) si dhe në tabelën e njoftimeve të bashkisë.

Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës joqeveritare, projekti i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, organizatës mund t'i kërkohen modifikime të caktuara në projekt për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 9 Korniza Logjike

Shtojca 10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë

Shtojca 11 Formulari i identifikimit administrativ dhe financiar

Shtojca 12 Deklarata për plotësimin e kriterëve

Shtojca A Deklarata e partneritetit

Shtojca B Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit